

PJESË E SHKËPUTUR NGA INTERVISTA E GJATË ME SHAQIR GASHIN

Bloomfield, New Jersey | Data: 7 shkurt 2015

Kohëzgjatja: 127 minuta

Të pranishëm:

1. Shaqir Gashi (I intervistuari)
2. Anna Di Lellio (Intervistuesja)
3. Sulejman Gashi (Intervistuesi)
4. Qazim Doda (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - e intervistuar shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Oda

Brëfimi i odave tona, odave të rinisë kanë randësi, po unë do t'flas për odën e babait tim që e kena pasë aty. Aty vijshin njerëz t'menqëm, rrijshin, bisedojshin për besën për nderin, për luftërat, për herojtë e popullit, për çdo gjë bisedojshin. Tregojshin mesela shumë interesante, për shembull na aty ishum si fmi, nuk e ndigjojshum se nuk u përzijshum shumë. Kur m'kujtohet sikur sot kur i tregojshin meselet njani prej tjetrit e ato meselet që u tregojshin u duhke me pas lidhje të bisedës, tani ajo meselja m'u kallxue. Tash une nashta nuk osht' n'lidhje me çka don me thanë po i tregoj disa mesele që i kom ndigju të asaj kohe.

Për shembull, n'ato odat tona vijke, vijshin ata pleqtë e asaj kohe, vijke Rexhë Lutani, Xhemë Lutani, Haris Aliti, Sokol Binaku - baba i Sandokanit, vijshin ata prej tërgalive, avijshin prej tana anëve shqiptarët e asaj kohe, ata pleqtë e asaj kohe, u tubojshin dhe bisedojshin. Për shembull i zoti i shpisë aty, ai ishte... vetë kur kishte mysafirë për qefi marrke kafën vetë ia bojke. Tani për shembull a vijshin mysafirë të tjerë, e kom një detal shumë interesant, nashta asht' me e tregue. Kom pas ndëgjue nëpër odat tona, kur vijke një mysafir pak i lartë, ai i zoti i shpisë atje e marrke cigaren t'u e pi me qelibar edhe e vetke, "Mirë se ke ardhë me mysafirë," thojke. "Po, kah t'kemi ty?", ata tregojshin, na jemi prej ni veni ma t'largët a prej Dukagjinit, a prej Mitrovicës anena. Thojke, "Po shumë mirë, mirë se ke ardhë". "A je n'parti?" e pytke ai plaku. Ai thojke, "Po valla bre axhë, jom n'parti". "Po a je fellë, a plitko-a fellë a cekët?" (qeshë) thojke "Jo valla, cekët!". E thojke, "N'qoftëse je cekët, kena me bisedu". E tani ia nisshin me mesele.

Për shembull m'kujtohen meselet e njoni-tjetrit që ia tregojshin. Osht' për shembull, une e kom pas ndigju një mesele aty të pleqëve të asaj kohe. Njoni prej atyne thojke, "Ka kenë një njeri fukara shumë, edhe ia ka arri për me u bo i pasun shpejtë. Po masi që u bo i pasun, mas një kohe t'shkurtë, u ba prapë fukara, edhe pleqtë e asaj kohe shkojnë edhe i thojnë 'Po si mund me kenë kjo gjë kur ti ishe fukara e u bane i pasun? Prej pasurie prapë u bane fukara?' 'Eh,' thotë 'more burra, për me u bo i pasun e me u bo i nershëm, e me u bo me i fitu' gjanat me nerë, thjeshtë e morra një guri t'mullinit, e qita n'gjyks edhe u nisa çakoit përpjetë, por me shumë munim. Kur dola atje, u nala pak me pushu', përpak m'ka rrshitë ai guri i mullinit e sa çelë e mshelë sytë ka ra e u bona qysh jom kanë". Kjo ishte një mesele domethanë, që kur t'e marrsh dikun një pasuri, ose qoftë ajo ekonomike, luftarake, do të thotë duhet me ru' se mos me lshu' gurin me t'rrshitë, se me t'rrshitë guri bahesh prapë qysh ke kenë.

Për shembull tregojshin të tjera mesela, për shembull Azem Bejta kur ka shku' në Kuvendin e Junikut. Atje e kanë pasë atë Kuvendin kanë kenë burrat e krejt asaj kohe t'luftës. Azemi ka kenë pak me trup i vogël, nuk ka kenë bash i gatë edhe u ulë aty te oxhaku edhe disa që ia kanë ni zanin Azemit kanë pas qef, "Kush o' Azemi?", "Qe qai qatje Azemi o' {dëfton me dorë}." "Ah, shumë mirë", s'kanë mujtë me thanë se iu ka dukë shumë i vogël. Por Azemi i ka ndigju ato fjalë edhe t'u nejtë, s'ka ba za hiç, i ka marrë dy bume [bomba] ia ka bo tak-tak {shpjegon me duar sesi Azemi i ka cakërru dy bombat} edhe i ka hedhë n'oxhak (qeshë). Krejt ata që thojshin që osht' me shtat i vogël, kanë kcy kanë ikë dikush për dere, dikush për dritare. Ai i ka marrë ato bumet, i ka ngrehë ka thonë, "Hajde more burra, a me juve do t'ja fillojmë luftën kështu? Ju prej një bumje ikët!".

Tjetër kom ndigjue për shembull, njoni prej asaj anëve tona ka pas dëshirë me u angazhu çetës të Azem Galicës. Edhe për me ditë tash se ku gjendet Azem Galica, u duftë me pasë kontakt me nanën e Azemit. Ka shku e ka gjetë nanë atje e thotë, "Hajde loke e hamë një sillë" edhe n'atë kohën kur e kom ndigjue prej pleqëve se e kena pas do bukë t'kelbëta përpos drunit. I kena ba të elbit, kanë kenë shumë bukë t'mira t'vogla. Edhe ajo e kish pas qitë një përpeq¹ edhe sa here e qitke bukën qëkaq t'vogël {përshkruan me duar}, ai që dojke me shku' me Azemin e hanke, nuk pritke me ardhë tjetra. Kshtu qi i hangër pesë-gjashtë bukë qashtu t'elbit edhe përpeqin edhe tash thotë "Ku asht' Azemi?". Kjo thotë, lokja thotë, "S'ma merr.menja që je për Azemin", thotë "për arsye se Azemi me këtë tokë bukë çka ke hangër ti, e me kto gjana, ai jeton me çetën e vete për shtatë ditë e ushqehet me këtë ushqim". Kshtu qi, ishte mësim i madh prej njerëzve që tregojshin turlifar meselesh, turlifar gjana t'mira.

¹Përpeq është një lloj qumështori me një petë, me vezë të rrahura me qumësht dhe me djathë të njomë, që piquet në tepsi; lloj byreku me qumësht e me djathë të njomë.